



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:201303

Datë: 09.11.2022

Numri i dokumentit: 03623956

P.nr.996/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shqipe Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurve A.R, A.G dhe F.B që të gjithë nga Gjilani për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-ës, të cilët i mbrojnë avokatët Ilir Rashiti, Shemsedin Pira dhe Elvira Haziri që të tre nga Gjilani si dhe të pandehurit F.S nga Gjilani për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të KPRK-ës të cilin e mbrojnë avokatja Vlora Kadriu nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1741/2022, të datës 24.10.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, të pandehurit A.R me mbrojtësin e tij avokatin Ilir Rashiti, i pandehuri A.G me mbrojtësin e tij avokatin Shemsedin Pira, i pandehuri F.B me mbrojtësen e tij avokaten Elvira Haziri dhe i pandehuri F.S me mbrojtësen e tij avokaten Vlora Kadriu, me datën 01.11.2022 mori dhe shpalli ndërsa me datë 09.11.2022 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1. A.R, nga babai B, dhe nëna F, e lindur K i lindur me datë ... në Gjilan, ku edhe jeton, student, i pa martuar, menaxher në renta car “A” në Gjilan, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal ...
2. A.G, nga babai L, dhe nëna F e lindur M, i lindur me datë ... në Gjilan, ku edhe jeton, , i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në renta car “A..”, në Gjilan, i gjendjes së

mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal ...

3. F.B, nga babai N dhe nëna B, e lindur C, i lindur me datë .. në Gjilan, ku edhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i renta car “A..”, në Gjilan, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal ....
4. F.S, nga babai R dhe nëna L, e lindur K, i lindur me datë ..... në Gjilan, ku edhe jeton, ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal ...

## JANË FAJTORË

### I.

Të pandehurit A.R, A.G dhe F.B

Sepse me datë 29.09.2022, rreth orës 12:10 minuta, në Gjilan, ..në bashkëkryerje i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të pandehurit F.S, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje mes vete, ku fillimisht i pandehuri A.G me të pandehurin F.S janë takuar në kafiterinë “M...” dhe aty janë fjalosur mes vete, më pas F.S ka dalur nga kafiteria dhe është nisur tek autolarja ndërsa A. G në ndihmë i vinë shokët e tij A.R dhe F.B dhe të tre së bashku shkojnë tek autolarja dhe e sulmojnë F.S, ku A. S me një brisk të mbyllur që e kishte në dorë, mjet i rrezikshëm i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor e ka goditur në kokë F.S ndërsa A.G ka marrë një bisht sëpate - shkop druri dhe e ka goditur dy-tre herë në shpinë dhe kokë F.S ndërsa F.B e ka goditur F.S me grushte në fytyrë duke i shkaktuar lëndime trupore i cili për shkak të lëndimit ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan-Emergjencë, që sipas ekspertizës mjeko - ligjore F.S ka pësuar gërvishje në kokë, fytyrë, në regjionin e nyjës së krahut të majtë, në parakrahun e majtë dhe në kofshën e majtë të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit.

-Me çka kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-ës.

### II.

I pandehuri F.S:

Sepse me datë kohë dhe vend si në dispozitivin një të këtij aktgjykimi, i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore F.B, ndërsa lëndime të lehta i ka shkaktuar A.R, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje mes

vete, fillimisht mes A. G dhe F.S, ku aty janë fjalosur mes vete, më pas F.S ka dalur nga kafiteria dhe është nisur tek autolarja, ku në ndërkohë afër autolarjes kanë shkuar edhe të pandehurit A.R, A.G dhe F.B, ku kanë filluar të fjalosen dhe fyhen mes vete, me ç'rast pasi sulmohet nga të pandehurit A.R, A.G dhe F.B, F.S nga vetura e tij ka marrë një shufër metalike, ngjyrë e zezë, mjet i rrezikshëm, i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor dhe i ka sulmuar A.R dhe F.B, ku A.R e ka goditur me shufër në kokë dhe këmbë, ku ka ndërhyrë F.B, duke e ka kapur dhe mbërthyer për trupi të pandehurin F, me ç'rast i pandehuri F e ka kafshuar F.B, me dhëmbë në veshin e majtë, duke ia këputur një pjesë të veshit, ku si pasojë e goditjes, A.R dhe F.B kanë pësuar lëndime trupore, të cilët kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal në Gjilan - Emergjencë, ndërsa F.B është operuar Spitalin Rajonal në Gjilan, që sipas ekspertizës mjeko - ligjore F.B ka pësuar plagë shqyese me amputim-shkëputje traumatike e 1/3 së poshtme të laprës së veshit të majtë, tronditje trunore, të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, ndërsa A.R ka pësuar ndrydhje të indeve të buta të kokës dhe gërvishje në të dy gjunjët të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit.

-Me çka ka kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës të pandehurit e lartcekur:

## I GJYKON

Të pandehurit A.G, F.B dhe A.R për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 120 (njëqindnjëzet) ditësh, të cilat dënime më pëlqimin e të pandehurve dhe në bazë të nenit 44 të KPRK-ës iu zëvendësohen në dënime me gjobë në shumën prej

nga 1500 € (njëmijepesëqind euro) për secilin prej tyre veç e veç, të cilat obligohen të paguajnë në afat prej 3 (tre) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të pandehurin F.S për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim më pëlqimin e të pandehurit dhe në bazë të nenit 44 i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 3000 € (tremijë euro), të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 3 (tre) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës të pandehurve A.R, A.G dhe F.S, koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 29.09.2022 deri me datë 28.10.2022 do t'iu llogaritet në dënimet e shqiptuara me gjobë.

I dëmtuari F.S në raport me veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil, po ashtu edhe të dëmtuarit A.R dhe F.B në raport me veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

Në bazë të nenit 115 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të KPP-ës nga i pandehuri A.G KONFISKOHET një shkop druri si mjet i kryerjes së veprës penale ndërsa nga i pandehuri F.S KONFISKOHET një shufër metalike ngjyrë e zezë po ashtu si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## AR S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 24.10.2022 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1741/2022 kundër të pandehurve A.R, A.G dhe F.B, që të gjithë nga Gjiilani për shkak të kryerjes së veprës penale në bashkëkryerje lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-ës dhe ndaj të pandehurit F.S nga Gjiilani për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të KPRK.

Më datë 28.10.2022 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, i pandehuri A.R me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Ilir Rashiti, i pandehuri A.G me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Shemsedin Pira, i pandehuri F.B me mbrojtësen e tij me autorizim avokaten Elvira Haziri dhe i pandehuri F.S me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokates Vlora Kadriu, në të cilën seancë të pandehurit e lartcekur secili prej tyre veç e veç pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohen secili prej tyre dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e tyre me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve për veprat penale për të cilat akuzohen secili prej tyre ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 të KPP-ës dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tyre, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht ky pranim i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-CA-1365 i datës 29.09.2022, deklaratat e dëshmitarëve R. I, H. H dhe R. G, deklaratat e të pandehurve A.R, A.G, F.B dhe F.S, raporti mjekësor me numër .. në emër të F.S, raporti mjekësor me numër .. në emër të A.R, raporti mjekësor me numër ... në emër të F.B, ekspertiza mjekoligjore e datës 20.10.2022 në emër të F.B, A.R dhe F.S, foto dokumentacioni, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 29.09.2022-një shufër metalike, ngjyrë e zezë, një shkop druri dhe një DVD dhe raporti i zyrtarit policor gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Të pandehurit A.R, A.G dhe F.B kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ndërsa
- I pandehuri F.S ka kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar se të pandehurve të lartcekur duhet t'iu shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, këto dënime do të jenë të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre, gjykata me rastin e matjes së dënimeve pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse të pandehurit me rastin e kryerjes së veprave penale kanë qenë të përgjegjshëm për veprimet e veta dhe secili prej tyre veprat penale i kanë kryer me dashje dhe atë direkte, pastaj gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesve, sjelljen e mëparshme të pandehurve, pranimin e fajit si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurit mori *pranimin e fajësisë* për veprat penale të cilat iu vihen në barrë secilit prej tyre dhe atë në një fazë të hershme të procedurës penale, *pendimin e tyre të cilin* gjykata e mori si pendim të thellë dhe real, *keqardhjen e shfaqur* nga ana e tyre për kryerjen e veprave penale, *kërkim faljen* e tyre ndaj njëri tjetrit përfshirë edhe atë në gjykatore, *sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale* meqenëse të njëjtit më nuk kanë pasur probleme dhe i kanë rregulluar raportet mes vete, *premtimin e tyre* që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale si dhe *faktin se kjo ishte hera e parë që* të njëjtit bien ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata mori *shkallën e lartë të dashjes të shfaqur* nga ana e të pandehurve sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del të pandehurit secili prej tyre veprat penale i kanë kryer me dashje dhe atë direkte, pastaj *këmbëngulësinë* e të pandehurve për ti kryer këto vepra penale për secilin prej të pandehurve ngase të

pandehurit A.R<sup>1</sup>, A.G dhe F.B së bashku kishin shkuar tek autolarja dhe e kishin sulmuar të pandehurin F.S me mjete të rrezikshme ashtu që fillimisht i pandehuri A. S i cili kishte me vete një brisk mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor e kishte goditur në kokë F.S ndërsa A.G kishte marrë një bisht sopatë-shkop druri dhe e kishte goditur dy –tre herë në shpinë dhe kokë F.S derisa F.B e kishte goditur me grushte në fytyrë duke i shkaktuar lëndime trupore ndërsa i pandehuri F.S kishte marr një shufër metalike mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor dhe e kishte sulmuar A.R dhe F.B, ku A.R e kishte goditur me shufër në kokë dhe këmbë dhe aty kishte ndërhyrë F.B, me ç’rast F.S e kishte kafshuar të njëjtin me dhëmbë në veshin e majtë duke ia këputur një pjesë të veshit, po ashtu si rrethana rënduese për të pandehurit gjykata mori edhe *shkallën e dëmit të shkaktuar nga të pandehurit me kryerjen e këtyre veprave penale* të cilat për të pandehurit A.R, A.G dhe F.B përfshinë lëndimin e lehtë të shkaktuar tek i pandehuri F.S ndërsa për të pandehurin F.S përfshinë lëndimin e rëndë të shkaktuar ndaj të pandehurit F.B andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës, gjykata të pandehurve iu shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5. Vendimi mbi konfiskimin e sendeve

Gjykata duke u bazuar në 115 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të KPP-ës nga i pandehuri A.G ka konfiskuar një shkop druri si mjet i kryerjes së veprës penale ndërsa nga i pandehuri F.S ka konfiskuar një shufër metalike ngjyrë e zezë po ashtu si mjet i kryerjes së veprës penale.

#### 6.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Gjykata duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarin F.S në raport me veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil po ashtu edhe të dëmtuarit A.R dhe F.B në raport me veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

---

<sup>1</sup> Në raport me të pandehurin A.R, gjykata të njëjtit ia aprovoi kërkesën për zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë edhe pse i njëjti këtë kërkesë e kishte paraqitur pas shpalljes së aktgjykimit gjithnjë me qëllim të mos keqësimit të pozitës së tij në procedurë në raport të pandehurit e tjerë e po ashtu duke pasur parasysh edhe parimin “in dubio pro reo” sa i përket zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë”.

### 7.Llogaritja e kohës së kaluar nën masën e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar

Gjykata duke u bazuar nënin 79 të KPRK-ës të pandehurve A.R, A.G dhe F.S kohën e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 29.09.2022 deri me datë 28.10.2022 ia llogariti në dënimin e shqiptuara me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve si dhe bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që të pandehurit ti detyrojnë të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.996/2022 me datë 09.11.2022.

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Shqipe Kastrati

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate themelore.